

## **HAPJA E PRAKTIKAVE TË DËMEVE**

Praktika e dëmit hapet në momentin e njoftimit të rastit të sigurimit nga:

- policmbajtësi
- përfituesi
- i siguruari

Njoftimi i rastit të ngjarjes së sigurimit bëhet sipas formularit përkatës dhe bëhet:

- me shkresë
- në mënyre elektronike apo dhe me
- telefon në Degë ose Zyrat Qëndrore të Kompanisë.

Kërkesa për dëmshtëpërblim paraqitet me shkrim.

## **AFATI I SHQYRTIMIT TË PRAKTIKËS SË DËMIT**

Praktika e dëmit shqyrtohet brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të dokumentit të fundit nga përfituesi, apo i siguruari.

Ky afat shtyhet deri në dorëzimin e dokumentit shtesë të fundit të kërkuar nga shoqëria e sigurimit;

Periudha e trajtimit të rastit të sigurimit do të jetë e ndryshme nëse kjo gjë është parashikuar në kushtet e kontratës së sigurimit.

Afat i shqyrtimit të praktikës shtyhet deri në vërtetimin e shkaqeve apo nxjerrjes së paaftësisë për rastet e:

- e paaftësisë së përhershme, kur nuk është e mundur të përcaktohet brenda një kohe të shkurtër shkalla e paaftësisë;
- vdekjes, kur rrethanat e ndodhjes së dëmit janë të paqarta dhe kërkojnë një periudhë të gjatë për t'u vërtetuar nga organet kompetente.

## **DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR PLOTËSIMIN E PRAKTIKAVE TË DËMEVE**

Njoftimi i rastit të sigurimit sipas formularit përkatës.

Polica e Sigurimit ose çertifikata e sigurimit (origjinale në rast vdekje).

Mandat arkëtimi, konfirmimi bankar ose urdhër xhirimi i primit/primeve të arkëtuara.

Dokumentacioni mjekësor (epikriza mjekësore, kopje të kartelës mjekësore, etj) sipas rastit të sigurimit që mbulon policia e sigurimit;

Dokumentacioni nga organet e policisë dhe ato të drejtësisë (gjykatë; prokurori) sipas rastit të sigurimit;

Skeda e vdekjes dhe çertifikata e vdekjes (kur i siguruari ka humbur jetën)

Çdo dokument tjetër sipas polices së sigurimit dhe të kërkuar nga INSIG JETE SH.A.